



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Pranuar me: Prilbjen:	15.05 2025	
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
VES 01-011/01-24381		K

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

PROCESVERBALI

NGA KONSULTIMI PUBLIK I

DRAFT RREGULLORES PËR

TAKSAT KOMUNALE

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I RREGULLORES PËR TAKSAT KOMUNALE

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin e draft rregullores për taksat komunale dhe zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK DRAFT RREGULLORES PËR TAKSAT KOMUNALE

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike ku ka qenë në diskutim publik draft rregullorja për taksat komunale edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://lipjan.rks-gov.net/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Me datë 18.04.2025 është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit-debatit publik i draft rregullores për taksat komunale.

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/04/Njoftim-per-Debat-publik-per-Projekt-Rregullore-per-Taksa-Komunale-shqip.pdf>

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I DRAFT RREGULLORES PËR TAKSAT KOMUNALE

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Me datën 30.04.2025 është mbajtur konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Në web faqe:

<https://lipjan.rks-gov.net/news/ne-sallen-e-kuvendit-te-komunes-se-lipjanit-gjate-dites-se-sotme-eshte-mbajtur-debat-i-hapur-publik-me-qytetare-per-te-diskutuar-projekt-rregulloren-per-taksa-komunale/>

Konsultimi publik është realizuar në kohën e paraparë dhe filloi në orën 10:00.

Draft rregullorja për taksat komunale u prezantua nga Shefja e Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryetarit të Komunës Vlora Krasniqi.

Vlora Krasniqi sqaroi para të pranishmëve se Komuna e Lipjanit ka përfillur të gjitha procedurat për të konsultuar me publikun këtë Draft Rregullore e cila pritet të miratohet në seancën e Kuvendit të Komunës dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafti pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete rreth kësaj draft rregulloreje.



Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, duke përfshirë: qëllimin e hartimit të kësaj draft Rregulloreje, taksat dhe bashkëpagesat, obligimet e zbatimit, llojet e taksave etj.

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I RREGULLORES PËR TAKSAT KOMUNALE

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Vlora Krasniqi – Shefe e Zyrës Ligjore të Komunës së Lipjanit diskutoj për qëllimin e nxjerrjes së kësaj draft rregulloreje, për taksat të cilat janë të përfshira si dhe disa taksa të cilat nuk kanë qenë të përfshira deri më tani në Rregulloren aktuale të Taksave Komunale.

Rafete Retkoceri Jetullahu – Zyrtare Ligjore në Drejtoratin për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim sqaroi se është bërë një plotësim i paragrafit 5 të nenit 9 të Rregullores aktuale të Taksave Komunale, nën ky i cili zbatohet nga Drejtoratin për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim.

Gafurr Hetemi –parashtron pyetjen se a ka mundësi të futen në taksë edhe subjektet e biznesit që marrin në shfrytëzim pronën komunale për 99 vite.

Vlora Krasniqi – jep sqarim se do të shqyrtohet mundësia për përfshirjen e kësaj takse në të ardhmen në kordinim edhe me grupet e interesit që do të mund të ndikoheshin nga ky proces. Komenti në këtë fazë nuk mund të pranohet por mbetet për tu shqyrtuar gjatë muajve vijues.

Valdete Muji parashtron pyetjen se pse janë hequr nga kjo Projekt Rregullore Taksat për fushën e pylltarisë.

Vlora Krasniqi – jep sqarim se Sektori i pylltarisë ka kaluar me Agjensionin për Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe tani më komuna nuk ka kompetencë të përcaktojë taksa në këtë fushë dhe kjo është arsyeja që dispozitat që rregullojnë këto taksa janë hequr nga kjo Projekt –rregullore.

Takimi përfundoi në ora 10:50

PROCESVERBALI NGA KONSULTIMI PUBLIK I DRAFT RREGULLORES PËR TAKSAT
KOMUNALE

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimitin publik-kontribuesve
1. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	15 ditë pranohen	13
2. Publikimi në ueb faqe	15 ditë	

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 13 pjesëmarrës, prej tyre 8 femra dhe 5 meshkuj.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike.

